



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:139389

Datë: 06.01.2020

Numri i dokumentit: 00748356

C.nr.51/2019

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA E GJYKATËS NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin e çështjes Shaban Zeqiraj në cilësinë e Gjyqtarin individual, si dhe me pjesëmarrjen e sekretares Juridike Ylkije Kryeziu duke vendosur në lidhje me padinë së **paditësit: Z. (R.) C.** nga fshati G. Komuna Suharekë të cilin e përfaqëson me autorizim Av.S. H. nga Suhareka, kundër të **paditurit: Q. L. B.** nga G. rr.”F. T.” p.nr, me objekt kontesti *Vërtetimi i të Drejtës së Shfrytëzimit të Përherëshëm në Paluajtshmëri*, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 06.01.2020, Gjykata në po të njejtën datë 06.01.2020, nxori këtë :

**AKTGJYKIM
(Në Bazë Të Pohimit)**

- I. APROVOHET** Padia dhe Kërkesëpafia e paditësit Z. (R.) C. në tërsi si e **BAZUAR**.
- II. VËRTETOHET** se Z. (R.) C. është **SHFRYTËZUES I PËRHERSHËM** i ngastrës kadastrale **P-72116012-00...-..** me sipërfaqe 791m2, në vendin e quajtur “...../.....”, me kulturë “Kullosë e Klasës së 5” e evidentuar në emer të Q. (L.) B..
- III. DETYROHET** i padituri Q. (L.) B. që paditësit Z. (R.) C. ti njohë të drejtën e **SHFRYTËZIMIT TË PËRHERSHËM**, dhe të njejtit ti lejon regjistrimin e kësaj të drejtë pranë regjistrave Kadastrale në Zyrën Për Shërbime Pronësore Juridike respektivisht Zyres Kadastrale Komunale Suharekë.
- IV. OBLIGOHET** Zyra Komunale Kadastrale Suharekë, që për ngastrën **P-72116012-00...-..** me sipërfaqe 791m2, në vendin e quajtur “...../.....”, me kulturë “Kullosë e Klasës së 5”, të bëj ndryshimet pranë regjistrave kadastral dhe për të njejtën ta regjistroj paditësin Z. (R.) C. si **SHFRYTËZUES I PËRHERSHËM**.
- V.** Shpenzimet e procedurës kontestimore i bartë secila palë të vetat.
- VI. KY AKTGJYKIM ËSHTË I PLOTËFUSHQISHËM ME DATË 06.01.2020, PASI QË PALËT NË PROCEDURË KANË HEQUR DORË NGA E DREJTA E ANKESËS.**

ARSYETIM

Rrethanat e kësaj çështje kontestimore.

Fillimisht Paditësi pranë Gjykatës ka prashtruar padi për vërtetim të pronësisë në bazë të pohimit, kundër të paditurit Q. L. B. nga fshati G. Komuna Suharekë.

Gjykata me çëllim të zhvillimit të procedurës lidhur me këtë çështje, ka caktuar seancë përgatitore për datën 10.12.2019, për të cilën seancë kanë prezentuar për paditësin i autorizuari i tij Av.S. H. nga Suhareka ndërsa për të paditurin personalisht Q. B..

Në këtë seancë i autorizuari i paditësit para fillimit të shqyrtimit përgatitor ka bërë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë në aspektin objektiv dhe subjektiv ku si paditës tani e tutje duhet të jetë Z. R. C. ndërsa objekt i kërkesëpadisë do të jetë të vërtetohet se paditësi është shfrytëzues i përhershëm i ngastrës 00...-.. me sip.791m2.

I autorizuari i paditësit pas marrjes së ekspertizës së ekspertit gjeodet ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sa i perket sipërfaqës ku ka kërkuar që paditësit ti njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm në sipërfaqe prej 791m2 sipas gjendes grafike në teren.

Prendimet e Palëve në Procedurë.

Pala paditëse lidhur me këtë çështje është deklaruar se të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm për këtë paluajtshmeri e kam blerë që para vitit 2000 nga i padituri, dhe të gjitha obligimet i kam kryer në atë kohë kur është arritur marrëveshja.

Po ashtu paditësi i ka propozuar gjykatës që të dilet me ekspert gjeodet në teren dhe të vërtetohet gjendja faktike.

I padituri personalisht në këtë seancë ka deklaruar se këtë të drejtë të shfrytëzimit ja kam shit paditësit në vitin 1997 dhe të gjitha mjetet në atë kohë mi ka paguar paditësi, dhe që nga koha e blerjes paditësi e ka në shfrytëzim të pandërpresë, andaj mbi bazën e kësaj i ka propozuar Gjykatës që ngastra kadastrale 00...-.. të regjistrohet si shfrytëzues, po ashtu i padituri ka deklaruar pranë gjykatës se e POHOJ padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe lidhur me këtë çështje nuk do të paraqitem më në Gjykatë.

Gjendja Faktike e Vërtetuar.

Gjykata me çëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike në kuptim të nenit **Nenit 356 të Ligjit të Procedurës Kontestimore** ka miratuar propozimin që të dilet me ekspertit gjedoet në teren, duke i caktuar detyrat e ekspertit që të identifikoj ngastrën kadastrale 00...-.. ZK G. dhe Gjykatës ti dorëzoj ekspertizën dhe skicën e terrenit.

Gjykata me datë 06.01.2020, ka pranuar ekspertizën e punar nga Eksperti Gjeodet H. D., ku Gjykatës i ka dorëzuar edhe skicat e terrenit.

Në këto rrethana Gjykata në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka bërë administrimin e provave materiale dhe atë:

- Shiqim-leximin në ekspertizën e ekspertit Gjeodet H. D. të datës 06.01.2020, dhe skicës së terrenit.
- Shiqim-leximin në certifikatën e pronësisë për ngastën kadastrale P-72116012-00...-.. me sipërfaqe 791m2, në vendin e quajtur “...../.....”, me kulturë “Kullosë e Klasës së 5” e evidentuar në emer të Q. (L.) B., me numër të lëndës .../2019, certifikatë lëshuar me datë 04.02.2019.

Gjykata pas administrimit të provave materiale dhe analizimit të rrethanave të çështjes, si dhe dëgjimit të deklarimeve të palës paditëse të cilat u pohuar në tërsi nga pala e paditur Gjykata vendosi që të APROVOI padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërsi si të Bazuar.

E Drejta Materiale e Aplikuar.

Gjykata pas çmuarjes me kujdes të provave materiale, dhe analizimit të rrethanave të kësaj çështje, si dhe deklarimeve të paleve në procedurë, gjeti se është plotësuar kushti për tu dhënë aktgjykim në bazë të pohimit, konform nenit 148 paragrafi 1 ku parashihet:

Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

E që në rastin e kësaj çështje pala e paditur që nga fillimi i seancës përgatitore e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të gjitha pretendimet e shprehura në padi pa asnjë kundërshtim, duke i propzuar gjykatës që ta aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

Andaj për Gjykatën, në bazë të fakteve të lartëcekura mjaftueshëm del THEMELËSIA e Kërkesëpadisë së paditësit, në atë mënyrë që vendosi ta APROVOI si të Bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u vendos konform nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA E GJYKATËS NË SUHAREKË,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.**

C.nr.51/2019, 2019:139390 - Datë : 06.01.2020.

**Sek.Juridike
Ylkije Kryeziu**

**Gjyqtari i çështjes
Shaban Zeqiraj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi nuk lejohet Ankesa pasi që palët në procedurë kanë hequ dorë nga e drejta e ankesës, dhe i njejti është i plotëfuqishëm me datë 06.01.2020.